



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 125 prot.

Fushë-Arrëz, më 15.01.2026

Procesverbal i mbledhjes së Kryesisë së Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 17; 56; 57 dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 15.01.2026, në sallën e mbledhjeve të këshillit, Kryesia e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e radhës.

Anëtarët e kryesisë vijuan me diskutimin e pikave të rendit të ditës për mbledhjen e datës 30.01.2026 për të cilat u ra dakort.

U ngarkua Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë dhe personat apo edhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili anëtar këshilli.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

KRYESIA

Nr. 125/prot.
11

Fushë-Arrëz, më 15.01.2026

VENDIM

PËR

“MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË RADHËS TË KB”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 17, neni 56, neni 57; Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz miratuar me VKB nr.15, datë 27.04.2020, Kryesia e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, në mbledhjen e datës 15.01.2026,

VENDOSI

1. Miratimin e **Njoftimit** dhe **Rendit të ditës** për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 30.01.2026, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit me rendin e ditës te çdo Këshilltar, te Kryetari i Bashkisë, personat apo organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili Këshilltar.
3. Ky vendim hy në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

